

VENDIM
Nr. 711, datë 11.11.2022

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 555, DATË 11.8.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË PERSONELIT MJEKËSOR, TË PUNONJËSVE ME ARSIM TË LARTË DHE TË PUNONJËSVE TË PERSONELIT TEKNIK TË SHKENCAVE MJEKËSORE, NË SISTEMIN E MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR SHËNDETËSINË, NË NJËSINË MJEKËSORE USHTARAKE PRANË SPITALIT UNIVERSITAR TË TRAUMËS, NË STRUKTURAT E TJERA TË FORCAVE TË ARMATOSURA DHE NË INSTITUCIONET E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE DHE SPITALIN PËRKATËS”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të personelit mjekësor, të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të personelit teknik të shkencave mjekësore, në sistemin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura dhe në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe spitalin përkatës”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa e ndryshime:

1. Pas pikës 20 shtohet pika 21, me këtë përmbajtje:

“21. Për një periudhë transitorë 2-vjeçare të punës për autonominë spitalore të spitaleve publike, në bashkëpunim me personat e caktuar nga Ministria e Shëndetësisë Turke, pagat e punonjësve turq në pozicionin “Menaxher spitalor” janë të njëjta me pozicionet respektive të punës sipas lidhjes nr. 1/AP.

Përveç pagës sipas lidhjes nr. 1/AP, punonjësit turq në pozicionet “Menaxher spitalor”, përfitojnë edhe një shpërblim mujor, në masën e përcaktuar në lidhjen nr. 10.”.

2. Në lidhjen nr. 1/AP, në nënndarjen 4, shtohet emërtesa “Menaxher spitalor në spitalet universitare e rajonale”.

3. Në lidhjen nr. 10 bëhen këto shtesa e ndryshime:

a) Titulli i lidhjes ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Shpërblimi për punonjësit e personelit të caktuar nga pala turke në Spitalin Rajonal “Memorial” Fier dhe për punonjësit turq në pozicionet “Menaxher spitalor në spitalet universitare e rajonale”;

b) Pas nënndarjes 11 shtohet nënndarja 12, me këtë përmbajtje:

12	Menaxher spitalor në spitalet universitare e rajonale	217 900
----	---	---------

II. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2022, përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e vitit 2022, për shërbimin spitalor.

III. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku